



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 170/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit Nisma për Kosovën dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren kështu që Nisma për Kosovën, dega në Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 04.06.2014, në ora 14:25 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se në rrugën – Ismet Jashari Kumanova- në Prizren ishte vendosur baneri i kandidatit Zenel Elshani nga subjekti politik Nisma për Kosovën. Sipas ankesës, është bërë shkelja e dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e posterëve në objekte publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj, subjekti Nisma për Kosovën me vendosjen e banerit në publik ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi- Nismën për Kosovën, me datën 05.06.2014, dhe i ka dhënë Urdhër për te Ndërmarrë masat Përmirësuese lidhur me ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë të kërkuar nga subjekti Nisma për Kosovën në të cilën thekson se vendosja e banerit në rrugë publike, të subjektit politik Nisma për Kosovën nuk është bërë nga strukturat e subjektit të tyre, vendosja është bërë nga qytetar apo individ të paidentifikuar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Nisma për Kosovën konfirmon se në momentin e njoftimit për ankesë ka kontaktuar Shtabin Zgjedhor për Komunën e Therandës për të bërë heqjen e këtij baneri të parashtruar në ankesë dhe në cilësinë e provës në përgjigje ia kanë bashkangjitur fotografinë në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterit të vendosur në shenjë të komunikacionit në qytetin e Therandës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizo shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i subjektit Nisma për Kosovën është vendosur në shenjën publike të trafikut në Komunën e Therandës, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon vendosjen e posterëve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;

PZAP-i, mori parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese, si rrethanë rënduese mori se subjekti në fjalë ka bërë përsëritjen e të njëjtës shkelje në këto zgjedhje dhe është konsideruar si recidiviste. Ndërsa si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin që subjekti në NISMA, pas marrjes së Kërkesës për Përgjigje në ankesë dhe pas dhënies së urdhrorit nga PZAP-i, për ta evituar shkeljen e pretenduar në ankesë, subjekti në fjalë i ka ndërmarr të gjitha masat për përmirësimin e shkeljes së supozuar, e cila çështje ka ndikuar në uljen e lartësisë së gjobës të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi ngase sipas Rregullores Nr. 01/2012 të PZAP-it për "Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave", gjoba lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë është 5010 euro.

PZAP-i, duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se subjekti NISMA, ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se "Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore" dhe poashtu duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura dhe në kuptim të 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 170/2014 më datën 08.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*